



Prishtinë: 30.03.2011

Kodi i ZRRE-së: V_354_2011

Nr.i Referencës: ZRRE/DMK_V_524_02_11

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke marrë parasysh:

1. Kompetencat e Zyrës së Rregullatorit për Energji të dhëna në nenin 14 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë;
2. Dispozitat sipas Kapitullit 3, Nenit 17 të Rregullës mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
3. Nenin 18 të Rregullës mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
4. Dëshmitë e paraqitura nga palët;
5. Vendimin e DMK të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_V_524_02_11**;
6. Apelimi i konsumatorit me datë 02.03.2011;

Në mbledhjen e mbajtur më 30 mars 2011 nxori këtë:

VENDIM

REFUZOHET apelimi i konsumatorit Ibish Krasniqi, (shifra e konsumatorit DPZ – 9023058) nga Prizreni, si në arsyet e paraqitura në arsyetimin e këtij vendimi.

Arsyetim

Konsumatori në ankesën e tij drejtuar DMK-së me datë 18.05.2010 ka apeluar përgjigjen e KEK Sh.A – Divizioni i Furnizimit – Departamenti për Konsumatorë të datës 13.04.2010 lidhur me kontestimin e ngarkesës së shfrytëzimit të paautorizuar.

- Me datë 22.06.2009 konsumatori ka bërë pagesën në vlerë 23€, për ndërrim njehsori.
Provë: Dëftesa DPZ09MC06221210187/37 e datës 22.06.2009
- Me datë 24.06.2009 konsumatori ka bërë kërkesë zyrtare pranë KEK-ut për ndërrim dhe kalibrim njehsori.
Provë: Aplikacioni për ndërrim njehsori i datës 24.06.2009
- Me datë 25.06.2009 punëtorët e autorizuar të KEK-ut për ndërrim njehsori kanë inspektuar pikën matëse të konsumatorit, ku kanë regjistruar të dhënat teknike të njehsorit elektrik nr. 45446891 të vendosur nga vetë konsumatori.
Provë: Vërtetimi mbi ndërrimin e njehsorit nr. 002999 i datës 25.06.2009
- Me datë 24.10.2009 punëtorët e qendrës së kalibrimit kanë bërë kontrollimin detal të njehsorit elektrik nr. 7792064, ku është konstatuar se njehsorit elektrik vulat (bllombat) shtetërore i ka të manipuluar të hapura dhe prapë të mbyllura nga ana e jashtme dëmtime tjera nuk ka si numëruesi i njehsorit është i manipuluar.
Provë: Procesverbali me nr. 08/24 i datës 24.10.2009
- Me datë 30.10.2009 punëtorët e autorizuar të KEK-ut për shqyrtimin e saktësisë së njehsorëve elektrik kanë shqyrtuar njehsorin elektrik nr. 7792064, ku kanë konstatuar se



njehsori elektrik është jashtë kufijve matës.

Provë: Protokoll i shqyrtimit të njehsorisë elektrike, datë 30.10.2009

- Me datë 26.01.2010 punëtorët e autorizuar të KEK-ut kanë inspektuar pikën matëse të konsumatorit dhe kanë bërë regjistrimin e të dhënave teknike të pikës matëse si dhe pajisjeve që posedon konsumatori.

Provë: Procesverbali i KEK-ut nr. 117251 të datës 26.01.2010

- Me datë 11.02.2010 KEK-u ka ngarkuar konsumatorin me ngarkesë për shfrytëzim të paautorizuar me anë të faturës DPZ10HP05055 në vlerë prej 943.64 €.

Provë: Fatura DPZ10HP05055 e datës 11.02.2010

- Me datë 15.03.2010 konsumatori ka parashtruar ankesë në Departamentin për Konsumator në KEK duke kundërshtuar ngarkesën për shfrytëzim të paautorizuar të energjisë elektrike.

Provë: Ankesa e konsumatorit në KEK

- Me datë 13.04.2010 Departamenti për Konsumator në KEK i është përgjigjur konsumatorit duke e refuzuar dhe duke thirrur në procesverbalin e kontrollës dhe të kalibrimit.

Provë: Përgjigja e KEK-ut e datës 13.04.2010

- Me datë 18.05.2010 konsumatori ka apeluar përgjigjen e KEK-ut në DMK të ZRRE-së.

Provë: Ankesa e konsumatorit në DMK të ZRRE-së

- Me datë 14.02.2011, DMK duke u bazuar në analizat e bëra lëndës së konsumatorit ka lëshuar vendimin nr. ZRRE/DMK_V_524_02_11 duke refuzuar ankesën e konsumatorit dhe ka kërkuar nga KEK-u që:

1. KEK-u duhet të bëjë rilloaritjen e faturës së rikthimit të humbjeve DPZ10HP05055 të datës 11.02.2010, duke marrë për bazë se energjia mesatare mujore e faturuar duhet të jetë 80 kWh/muaj.

Bordi i ZRRE-së ka analizuar vendimin e lëshuar nga DMK: ZRRE/DMK_V_524_02_11 dhe ka konstatuar se vendimi është në pajtim me Rregullat e ZRRE-së. Apeluesi nuk ka ofruar ndonjë dëshmi shtesë kundër këtij vendimi, andaj Boardi i ZRRE-së ka vendosur ta **refuzojë** konsumatorin për arsyet e paraqitura në vendimin e DMK të ZRRE-së.



Këshillë Juridike: Kundër këtij Vendimi, pala ka të drejtë të iniciojë procedurë gjyqësore në Gjykatën Kompetente, brenda **katërmëdhjetë (14) ditësh** prej ditës së pranimit të këtij Vendimi.

Bordi i ZRRE-së

Dr. Ali Hamiti, kryesues

Përparim Kabashi, anëtar

Blerim Koci, anëtar